



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.E.nr.6/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq anëtarë, në çështjen juridike të paditësit “TEB” Sh.A. me seli në P. – ..., Magjistratja Prishtinë-Ferizaj, KM-7, kundër të paditurve “K.P.” Sh.P.K. nr. Biznesi ..., Zona Industriale – 1, P., M. J. nga P., dhe I. Z. nga fsh..., Komuna e F. K., për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas revizionit të paditurit I. Z., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së dytë, K.Dh.Sh.II.nr.1513/2022 dt.2.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.03.2024, mori këtë,

A K T V E N D I M

HEDHET si i palejuar revizioni i të paditurit I. Z. nga fsh..., Komuna e F. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, K.Dh.Sh.II.nr.1513/22 datë 2.06.2023.

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, II.EK.nr.700/19 dt.28.12.2021, aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit, detyrohen të paditurit, që paditësit në emër të borxhit të mbetur nga Marrëveshja për Kredi, me nr.53727 e dt.1.03.2016, t’ia paguajnë shumën prej 69,925.83 euro, me kamatë në lartësinë prej 8% në vit, duke filluar nga data 21.11.2019, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 150.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së dytë, K.Dh.Sh.II.nr.1513/2022 dt.2.06.2023, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit “K.-P.”, Zona Industriale-1, në P., M. J. nga P., kurse, aktgjykimi i sipër përmendur i gjykatës së shkallës së parë, është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri I. Z. nga fsh...., Komuna e F. K., ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të aprovohet revizioni dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, të aprovohet revizioni dhe të anulohen aktgjykimet e instancave më të ulëta gjyqësore dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në revizion ka paraqitur pala paditëse nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës si dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i të paditurit I. Z., është i palejuar.

Me dispozitën e nenit 211.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet se ” Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi ”. Pra, nga kjo dispozitë ligjore rezulton se revizioni si mjet juridik i jashtëzakonshëm mund të paraqitet ekskluzivisht kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe se nuk mund të ketë revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Revizioni paraqitet kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është vendosur në lidhje me ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në rastin konkret civil juridik, duhet theksuar se, kundër aktgjykimit të sipër përmendur të gjykatës së shkallës së parë, kishte paraqitur ankesë vetëm i padituri “K.-P.”, me seli Zona Industriale – 1, P., M. J. nga P., por, jo edhe i padituri I. Z. nga fsh...., Komuna e F. K. Ndërsa, më pastaj, kundër aktgjykimit të sipër cekur të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri “K.-P.” Zona Industriale -1, me seli në P., M. J. nga P., nuk ka paraqitur fare revizion, ndërkohë që, tani kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paraqet revizion i padituri I. Z., nga fsh...., Komuna e F. K., edhe pse paraprakisht, sikundër u theksua më lartë, nuk kishte paraqitur fare ankesë kundër

aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Prandaj, nga këtu, në këtë gjendje të çështjes, duhet theksuar se parakusht themelor për paraqitjen e revizionit është paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, gjë që, sikundër u theksua më sipër, i padituri I. Z. nga U., Komuna e F. K., nuk kishte paraqitur fare ankesë kundër aktgjykimit të sipër përmendur të gjykatës së shkallës së parë.

Prandaj, nga të lartë cekurat, pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 218 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.E.nr.6/2024 dt.18.03.2024

Kryetari i kolegjit
Mr.Sc. Muhamet Rexha

